




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



N.SH. "Intersat"
Numri i biznesit - 70418771
Pronar – Tomor HALILAJ
OSH N.SH. INTERSAT
Drenas

Ref:1901/054/LIC/ni

VENDIM

për ndërprerjen e licencës të Operatorit të Shpërndarjes (OSH) N.SH. Intersat, me seli në Drenas

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. N.SH. Intersat është operator i shpërndarjes i licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për shpërndarjen e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale përmes rrjetit kabllorë, në pajtim me Rregulloren KPM-2016/01, me seli në Prizren. KPM, me datën 6 qershor 2013, ka marr vendim për dhënien e licencës për operatorine e shpërndarjes N.SH. Intersat.
3. Më datën 21 dhjetor 2018, pronari i operatorit të shpërndarjes N.SH. Intersat, përmes një shkrese të dorëzuar në KPM, ka njoftuar se heq dorë nga licenca e operatorit të shpërndarjes.

Arsyetimi

4. Duke marrë parasysh njoftimin e pronarit të operatorit të shpërndarjes N.SH. Intersat, për heqje dorë nga licenca në mënyrë vullnetare, Komisioni konstaton, se ka bazë të mjaftueshme për ndërprerjen e licencës së N.SH. Intersat.

Vendim

5. Komisioni, në takimin e tij të mbajtur më datën 31 janar 2019, merr vendim për ndërprerjen e licencës së operatorit të shpërndarjes N.SH. Intersat, ndërsa, shlyerja e

obligimeve ndaj tarifës vjetore për licencë të KPM-së, të bëhet në pajtueshmëri me procedurat e parapara me legjislacionin në fuqi.

6. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.



Muja FERATI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



31.01.2019

datë